

## Projekti : “MANDAGREEN” - PMSM (Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore Berat)

Vendi i zbatimit: **Berat**, Kohëzgjatja: **12 muaj**

### OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

**Objektivi i përgjithshëm:** Të zhvillohet një model i qëndrueshëm bujqësor në Berat përmes reduktimit të pesticideve, promovimit të praktikave ekologjike dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen mjedisore.

#### Objektivat specifike:

**1:** Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve të fermerëve për praktika të sigurta dhe ekologjike në kultivimin e mandarinave.

**2:** Krijimi i një modeli praktik të menaxhimit të qëndrueshëm të mandarinave dhe advokimi për përhapjen e praktikave ekologjike në nivel lokal dhe rajonal.

#### **PSE ËSHTË ME RËNDËSI ADRESIMI I KËSAJ ÇËSHTJEJE?**

Përdorimi i pesticideve të ndaluara ka shkaktuar kthimin e produkteve shqiptare nga tregjet e BE-së si të dëmshme për shëndetin e konsumatorit. Ato janë konsumuar në mënyrë të pakontrolluar në tregun e brendshëm ndaj Prodhimi dhe konsumi i produkteve ka rrezikuar shëndetin publik, ka dëmtuar mjedisin, ekonominë ndaj duhet ndërhyrje urgjente për të garantuar sigurinë ushqimore dhe biodiversitetin lokal.

#### **PROJEKTI NË NUMRA:**

- 11 aktivitete të planifikuara, anketime me të paktën **70 fermerë**, minimalisht 45 fermerë të trajnuar, 1 parcelë demonstrimi ekologjike në terren, 1 raport teknik nga parcela e demonstrimit; 1 policy response, 1 forum lokal.

- 100 qytetarë pjesëmarrës në fushata ndërgjegjësimi, 1 grup advokues me të paktën 12 anëtarë.

#### **IMPAKTI AFATGJATË I PROJEKTIT:**

Adoptimi i praktikave ekologjike nga fermerët lokalë dhe ndikimi në politikat vendore për bujqësi të qëndrueshme, me efekt të drejtpërdrejtë në sigurinë ushqimore dhe mjedisin.

#### **GRUPI I INTERESIT:**

Fermerët e zonës së Goriçanit, Banaj, Syzës dhe Kuçit që kultivojnë mandarina dhe komuniteti lokal.

#### **PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË:**

Familjet konsumatore, komuniteti i Beratit dhe mjedisi lokal që përfitojnë nga siguria në produktet bujqësore.

#### **REZULTATET E PRITSHME:**

Fermerët do fitojnë njohuri për bujqësinë ekologjike; një parcelë demonstrimi si mini model praktik; do krijohet një grup advokues që ndërvepron me institucionet; dhe komuniteti lokal do të jetë më i ndërgjegjshëm për rreziqet e pesticideve; Materiale edukative, forume , fushata ndërgjegjësimi, një letër pozicionimi për politikat lokale.

#### **AKTIVITETET KRYESORE:**

Studim fillestar mbi përdorimin e pesticideve dhe nevojat e fermerëve; Trajnime praktike me 45 fermerë për alternativa natyrore; Krijimi dhe monitorimi i një parcele demonstrimi nënjë zonat e Bashkisë Dimal (Ura Vajgurore). Hartimi, konsultimi dhe shpërndarja e udhëzuesit dhe materialeve edukative mbi bujqësinë ekologjike; Formimi i një grupi advokues për bujqësi të qëndrueshme; Fushatë ndërgjegjësuese në komunitet dhe media sociale; Organizimi i një Forumi Lokal për ndikimin në politika; Materialeve vizuale dhe Policy response mbi praktikën e mira të përdorimit të pesticideve, uljen e ndotjes së tokës; Pjesëmarrje në aktivitetet advokuese të rrjetit GreenAL dhe kontribut në EU progress report dhe Green Transition Report.

**Ky website është krijuar nga projekti Green AL, i zbatuar nga Co-PLAN, COSV dhe VIS Albania. Pikëpamjet dhe përfundimet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Suedeze ose të Sida-s, Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim (Sida).**